



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BANKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI MBIKËQYRËS

Projekt

V E N D I M

Nr. \_\_\_\_\_, datë \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.\_\_\_\_\_

**PËR DISA NDRYSHIME NË RREGULLOREN  
“PËR KREDINË KONSUMATORE DHE KREDINË HIPOTEKARE”**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 1, pika 4, shkronja “b”, nenit 12, shkronja “a” dhe nenit 43, shkronja “c” të ligjit nr.8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë”, i ndryshuar; dhe nenit 124 të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006 “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, me propozimin e Departamentit të Mbikëqyrjes,

**VENDOSI:**

1. Në rregulloren “Për kredinë konsumatore dhe kredinë hipotekare”, miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 48, datë 1.7.2015, e ndryshuar, të bëhen ndryshimet e mëposhtme:
  - a) Në nenin 5, pika 2, shkronja “a/1”, togfjalëshi “*si mesatare e normës efektive të interesit të aplikuar nga subjektet sipas llojit të kredisë konsumatore, duke konsideruar/shtuar edhe një të tretën e saj siç përcaktohet në këtë rregullore.*”, zëvendësohet me togfjalëshin “*sipas përcaktimeve të nenit 14 të kësaj rregulloreje.*”;
  - b) Në nenin 6, pika 2, bëhen ndryshimet e mëposhtme:
    - i. në shkronjën “g”, fjala “*këstit*”, zëvendësohet me fjalën “*kësteve*”,
    - ii. në shkronjën “o”, togfjalëshi “*(kësteve/principalit/interesit)*”, zëvendësohet me togfjalëshin “*(këstit/kësteve të kredisë, që në çdo rast përfshijnë vetëm kryegjënë dhe interesin)*”;
  - c) Në nenin 7, pika 2, bëhen ndryshimet e mëposhtme:
    - i. në shkronjën “j”, togfjalëshi “*shumën e këstit*”, zëvendësohet me togfjalëshin “*vlerën e kësteve*”,
    - ii. në shkronjën “p”, togfjalëshi “*(kësteve/principalit/interesit)*”, zëvendësohet me togfjalëshin “*(këstit/kësteve të kredisë, që në çdo rast përfshijnë vetëm kryegjënë dhe interesin)*”, si dhe pas togfjalëshit “*(këstit/kësteve të papaguar*

*të kredisë”, shtohet togfjalëshi “, që në çdo rast përfshijnë vetëm kryegjënë dhe interesin”;*

d) Në nenin 14, pas pikës 1 shtohet pika 1/1 me përmbajtjen e mëposhtme:

*“1/1. Përjashtim nga parashikimet e pikës 1 të këtij neni bëjnë kategoritë e kredisë konsumatore, në intervalin e shumave të disbursuara 0-200.000 lekë (ose ekuivalenti në monedhat e huaja), për të cilat Banka e Shqipërisë përcakton normën efektive maksimale të interesit sa mesatarja e thjeshtë e normës efektive të interesit për kredinë konsumatore në intervalin e lartpërmendur.”;*

e) Pas nenit 15, shtohet neni 15/1 me përmbajtjen e mëposhtme:

***“Neni 15/1***

***Kërkesa për komisionet në kontratat e kredisë konsumatore***

*Për kontratat e kredisë konsumatore, komisionet që lidhen me aplikimin për kredi, procesimin, administrimin, miratimin dhe disbursimin e kredisë, paguhen nga konsumatori në momentin e disbursimit të kredisë dhe nuk shpërndahen gjatë jetëgjatësisë së kredisë.”.*

2. Ngarkohen subjektet e kësaj rregulloreje me zbatimin e këtij vendimi.
3. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes së Bankës së Shqipërisë për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.
4. Ngarkohet Kabineti i Guvernatorit dhe Departamenti i Kërkimeve me publikimin e këtij vendimi, përkatësisht në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë dhe në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**SEKRETARI**

**KRYETARI**

**Elvis Çibuku**

**Gent Sejko**